



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

Nr. 1134/1 Prot.

Vlorë më, 04.08. 2022

VENDIM

Nr. 13, datë 04.08.2022

PËR
MIRATIMIN E PROJEKT- BUXHETIT AFATMESËM 2023-2025 TË
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 40, pika 1, gërma g, të ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 26, pika 3, gërma b dhe c, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si dhe referuar, shkresës së Administratorit nr.865/3 prot, datë 02.08.2022, në mbledhjen e datës 04.08.2022 Rektorati,

VENDOSI:

1. Të miratojë projekt-buxhetin afatmesëm 2023-2025 të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim së bashku me materialin shoqërues i përcillet për diskutim dhe miratim Senatit Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËS REKTORI AKADEMIK
PROF. AS. FROSINA LONDO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Nr. 6513. Prot.

Vlorë më, 02.08.2022

Lënda: Relacion argumentues për projekt -buxhetin afatmesëm 2023-2025, të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë

REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

PROF. DR. ROLAND ZISI

I nderuar!

Projekt-Buxheti afatmesëm 2023-2025 i Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë, është hartuar në mbështetje të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 30/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, të ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MAS dhe MFE "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", VKM-së nr.75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor" Vendimit nr. 130, datë 02.03.2022 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025", Udhëzimit nr. 7 datë 28.2.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", planit strategjik të Universitetit 2018-2024, Grupi i punës i ngritur për hartimin e PBA 2023-2025, me urdhër të Administratorit nr. 82 datë 20.06.2022, bazuar në kërkesat e njëjësive kryesore, drejtorive, sektorëve, koordinatorëve të projekteve si dhe në respektim të kuadrit ligjor të sipërcituar përgatiti materialin për PBA 2023-2025 mbi të cilin po ju përcjellë relacionin si më poshtë:

Në hartimin e këtij projekt - buxheti është marrë në konsideratë situata financiare e UV-së e cila është e lidhur dhe kondicionohet nga faktorë si më poshtë:

1. Granti i përvitshëm buxhetit të shtetit për UV.
2. Të ardhurat e siguruar nga vetë UV prej pagesave të studentëve.
3. Pakësimi i përvitshëm i numrit të studentëve në shumë programe studimi.
4. Mungesa e studentëve në 3 vitet e fundit në disa programe studimi.
5. Mbingarkesat mbi 200 orë e parashikuar në udhëzimin përkatës.
6. Numri personelit të ftuar dhe me kohë të pjesëshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR**


7. Numri i studentëve të përjashtuar nga tarifa e shkollimit.
8. Numri i Studentëve Bachelor të cilët përfitojnë reduktim nga tarifa e shkollimit.
9. Numri i studentëve të MP/MSH të cilët përfitojnë reduktim nga tarifa e shkollimit.

Nisur nga vlerësimi i faktorëve aktual objektivat kryesore ne hartimin e PBA-së 2023-2025 janë:

- ✓ Investimi për krijimin e infrastrukturës sa më të përshtatshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, aktiviteteteve akademike, mbështetjes studentore, promovimit të institucionit tonë në rajon e më gjerë, duke krijuar kushte sa më të favorshme për këtë qëllim.
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së mjediseve mësimore duke krijuar kushte sa më bashkëkohore për të ofruar një shërbim sa më cilësor.
- ✓ Plotësimi nevojave të paraqitura nga fakultete.
- ✓ Rritjen e qëndrueshme afatmesëme të të ardhurave të institucionit.
- ✓ Krijimi i kushteve bashkëkohore për mësimdhënie.
- ✓ Përdorimi me efikasitet i fondeve buxhetore.
- ✓ Sigurimi i stabilitetit financiar.
- ✓ Përfshirjen në sa më shumë projekte zhvilluese akademike shkencore në kuadrin e projekteve të arsimit të lartë.
- ✓ Ndërkombëtarizimin e aktiviteteteve kërkimore shkencore.
- ✓ Inkurajimin, zhvillimin dhe dinamizimin e aktiviteteteve kërkimore shkencore duke bashkëpunuar me struktura të tjera të kërkimit shkencor brenda dhe jashtë vendit.
- ✓ Realizimin e kërkimit shkencor dhe shpërndarjen e rezultateve të kërkimit të stafit akademik me qëllim rritjen e impaktit të kërkimit në publik.
- ✓ Përfshirja e studentëve në aktivitete kërkimore.
- ✓ Integrimin e veprimtarisë kërkimore - shkencore me atë të mësimdhënies në nivele reale dhe jo vetëm teorike, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aftësimin profesional të studentit , por edhe për të patur një impakt pozitiv në zhvillimin e rajonit.

Buxheti i vitit 2023-2025 mbulon shpenzimet si më poshtë:

- Shpenzimet për paga dhe sigurime për gjithë vitin.
- Mbingarkesën totale (mbi 200 orë + jashtë auditorit), sipas parashikimeve të përcjella nga Zv. Rektori Akademik për secilin Fakultet.
- Pagesën për stafin akademik të ftuar dhe me kohë të pjesshme.
- Shpenzime për akreditim
- Shpenzime në mbështetje të aktiviteteteve të organizuara nga studentët.
- Veprimtaritë Kërkimore- Shkencore të Departamenteve.
- Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

Shpenzime për rimbursim të botimeve dhe artikujve shkencor.

- Shpenzime për organizim konferencash.
- Shpenzime për organizim workshop, aktivitete të ndryshme të departamenteve.
- Udhëtime brenda dhe jashtë vendit.
- Shpenzime në mbështetje të praktikave mësimore dhe ekspeditat studentëve.
- Shpenzime për trajnime dhe seminare.

Në plotësim synimeve të mësipërme dhe gjendjes financiare të institucionit, në parashikimin e shpërndarjes së të ardhurave për përdorim për vitin 2023-2025 kemi planifikuar fondet e nevojshme me prioritetet si më poshtë:

Prioritetet kryesore të PBA 2023-2025 janë:

Investimet, përmes të cilave synojmë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, si në ngritje laboratoresh për programe të ndryshme studimi, blerje literature, dhe përmirësimin e ambienteve fizike me qëllim krijimin e kushteve sa më të përshtatshme dhe sipas standardeve bashkohore si për studentët dhe për stafin akademik.

Ndërtimi i godinës së re të Fakultetit të Shëndetit: Vazhdon të jetë prioriteti kryesor i UV-së për të cilin është lidhur kontrata nr. 15/24 pr. l., datë 11.06.2021 me vlerë totale 415,689.000 lekë. Ngritja e godinës për Fakultetin e Shëndetit është parashikuar të financohet 70% nga buxheti i shtetit, sipas shprehësës së MAS nr. 2091/4 pr. l. datë 02.06.2021, dhe 30% nga të ardhurat e Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë.

Për vitin 2023-2025 shpenzimet për ngritjen e Godines për Fakultetin e Shëndetit janë si më poshtë:

Financim	Emërtimi projektit	Fondi Total	2022	2023	2024
Buxheti	Ndërtim i godinës Fakultetit të shëndetit"	290,982,758	122,000,000	148,982,757	20,000,000
Të ardhura	"Ndërtim i godinës Fakultetit të shëndetit"	124,706,896	124,706,896	0	
	TOTALI	415,689,654	246,706,896	148,982,757	20,000,000

Ndërtimi Ramp-e dhe shkallë emergjence; bazuar në kërkesën e sektorit të shërbimeve për vitin 2023 do të ndërtohen rampa ne hyrje për godinen A dhe B, për personat me aftësi të kufizuara, në vlerën 900,000 lekë.

- Gjithashtu bazuar në vkm-në nr. 418 datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

degëvetë tyre", pika ç) objektet e arsimit të lartë, me më shumë se 200 studentë (në një godinë), detyrimisht duhet të jenë të pajisur me dalje dhe shkallë emergjence, duke vlerësuar ecurinë e buxhetit pas një studimi paraprak të kostos së nevojshme për ndërtimin e tyre dhe nivelin e të ardhurave në buxhetin e vitit 2023 do të kushtohet vëmendje ndërtimit të shkallëve të emergjencës.

Blerje paisje fotokopje-printera: Bazuar në kërkesat e fakulteteve si dhe në evidencimin e gjendjes fizike të paisjeve fotokopje-printer në fakultete, për të siguruar ecurinë normale bazuar dhe në volumin e punës janë parashikuar të blihen paisje profesionale fotokopje printer scanner(All in ONE) në vlerën 2.700,000 lekë.

Blerje inventar ekonomik; Duke qene se karriket e stafit në FSHTN janë të amortizuara dhe të dala jashte funksionit primar të tyre, bazuar në kërkesat e FSHTN dhe Sektorit të Shërbimeve është parashikuar të blihen 70 karrike rrotulluese, për stafin akademik.

Për vitet 2024-2025 bazuar në nivelin e të ardhurave të parashikuara ecurisë së buxhetëve në vite si dhe kërkesave të përditësuara të fakulteteve prioritet do të kenë investimet në fonde biblioteka blaja e një game të gjerë literature për bibliotekën që do t'ju shërbejë stafit akademik si edhe studentëve, laborator në mbështetje të procesit mësimor, të zivillimit të praktikave mësimore, si dhe mobilin bashkëkohor për godinën e re.

Gjithashtu në fokus do të jetë edhe përmirësimi i infrastrukturës së ambienteve me mjete të logjistikës për mirëfunksionimin e mësimdhënies.

- *Financimi i aktiviteteve (ose shpenzimeve) me karakter të drejtpërdrejtë për forcimin dhe thellimin e kërkimit shkencor dhe rrirjen e cilësisë së mësimdhënies, për aktivitete shkencore në Departamenteve*

Për këtë synim në projekt- buxhetin 2023-2025 janë parashikuar fonde që mbështesin:

- Veprimtaritë Kërkimor- Shkencore të Departamenteve.
- Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca.
- Shpenzime për rimbursim të botimeve dhe artikujve shkencor.
- Shpenzime për organizim konferencash.
- Shpenzime për organizim workshop, aktivitete të ndryshme të departamenteve.
- Udhëtime brenda dhe jashtë vendit.
- Shpenzime në mbështetje të praktikave mësimore dhe ekspeditat studentëve.
- Shpenzime për trajnime dhe seminare.

- *Mirëmbajtja e infrastrukturës së institucionit dhe shpenzimeve në mbështetje të aktivitetit të përditshëm.*

Në parashikimet e projekt-buxhetit 2023-2025 është bërë një analizë e detajuar e shpenzimeve të viteve të kaluara, e kërkesave të fakulteteve, e problematikave të hasura në vite, gjendjes së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

materialeve në magazine, duke synuar të jomi sa më afër realizimit të kërkesave, në mënyrë që të reduktojmë shpenzimet e panevojshme dhe të synojmë realizimin e shpenzimeve të domosdoshme për kryerjen e aktivitetit normal të punës në institucion.



Janë parashikuar shpenzime për mirëmbajtje të paisjeve elektronike, elektrike, përballimin me bazë materiale të mjaftueshme për gjithë vitin, si edhe të mbulohen detyrimet të domosdoshëm të cilat do të mundësojnë shpenzimet në rritje në disa zëra si: shpenzime për akreditim programesh, energji, ujë, telefon, në shërbimet që dalin të detyruara si p.sh. shpenzimet për rojet private, shpenzimet për internetin, shpenzime për mirëmbajtje, shpenzime për qira, pagesë e anëtarëve të BA-së, Senatit Akademik etj.

- *Financime për këshillat studentore për aktivitete të ndryshme me karakter social, apo bashkëpunues me universitete të tjera.*

Bazuar në kërkesat të drejtorive në Rektorat për zhvillim aktiviteteve është parë e arsyeshme të akordohen fonde me qëllim aktivizimin dhe mbështetjen e studentëve në veprimtaritë social-kulturore dhe shkencore me impakt universitar për të qënë jo vetëm kontribues për krijimin e të ardhurave për institucionin, por edhe protagonist për veprimtari të cilat kanë një ndikim pozitiv në jetën e Universitetit, shtetit dhe më gjerë. Nga ana jonë planifikohet ky fond për të mbështetur studentët për të financuar veprimtaritë e tyre, sipas nenit 99, pika 6 e ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë"

- *Shpenzime për mbështetjen e projekteve me Financim të Huaj me qëllim arritjen e bashkëpunimit të UV-së me rajon dhe më gjerë.*

Në projekt- buxhetin e vitit 2023-2025 janë parashikuar të mbulohen të gjitha kërkesat për bashkëfinancim nga institucioni dhe pagesë TVSH-je për blerje paisje për projektet me Financim të UV ka disa vite që është përfshirë në përfitimet e fondeve nga projektet e huaja në kuadër të akteve ligjore e nënligjore që Shteti Shqiptar ka me Bashkimin Europian. Përfshirja në këto projekte ka ndikuar si në krijimin e infrastrukturës akademike, në laboratorë e zyra edhe në mobilitet e personelit akademik e studentëve. Këto projekte financohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me Institucionin e Arsimit të lartë që aplikon, ndërkohë që menaxhimi i tyre realizohet në zbatim të procedurave të menaxhimit të buxhetit në Shqipëri. Për vitet 2023-2025 bazuar në ecurinë e projekteve dhe shkresave të koordinatorëve pritet të disbursohen 129,657 Eur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

Kodi i Projektit	Nazimi i Projektit	Tipi i Kontraktit ose Kërkesës	Emri i Mësimtarit Koordinatorit të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Vlera Totale e Projektit (Kam) EUR	Vlera e Transfereve pritëse të objektivit për vitin 2023 (EUR)	Kërkesa për bashkëfinancim nga Institucioni për vitin 2023 (EUR)	Vlera e pajisjeve që do të blidhen për vitin 2023 sipas bashkëfinancimit të projektit (Kam) (EUR)	Viti (tari)	Vlera e Transfereve blidhe për vitin 2023 (EUR)	
1	18CJ923	Pol.ATF	BE	Anneta Panajoti	2020	2023	28,600	9,600	1,500			
2	18CJ926	STEAM Edu	BE	Anneta Panajoti	2021	2024	58,722	19,500	2,300	19,500	3,900	
3	18CJ920	KNOWHUB	BE	Enxheljdi Nichilli	2019	2022	122,865			Përfundon në vitin 2022		
4	18CJ924	SUCCESS	BE	Elzenia Piero	2020	2023	72,400	7,240				
5	18CJ928	D	BE	Marmela Mico	2020	2022	83,025					
6	18CJ921	TANGRAM	BE	Nehilohi Agimaj	2019	2022	135,745			Përfundon në vitin 2022		
7	18BD831	AFRIMED	BE	Irina Nasto	2019	2022	90,000			Përfundon në vitin 2022		
8	18BD832	PHAREM	BE	Roland Zisi	2018	2021	157,988			Përfundon në vitin 2022		
9	18DL002	Clubs	BE	Eva Cipi	2018	2021	102,978			Përfundon në vitin 2022		
10	18CJ922	EmAl	BE	Eva Cipi	2021	2024	71,922	22,476	1,200		7693	
11	18CJ917	SE3C	BE	Eva Cipi	2021	2024	32,600			Përfundon në vitin 2022		
12	18CJ915	MEP&M	BE	Kristofor Lapa	2021	2024	150,159	45,047	5,920	15,015		
13	20AB203	BLUEWBC	BE	Kristofor Lapa	2020	2023	184,991	18,499		Përfundon në vitin 2022		
14	18CA727	ALMARS	BE	Kristofor Lapa	2019	2022	70,344			Përfundon në vitin 2022		
15	18DE062	MARDS	BE	Kristofor Lapa	2018	2021	72,265	7,225		Përfundon në vitin 2022		
15	Total						1,436,434	129,687	10,920	34,515	3,900	7,693

Projektet Mards, Bluewbc, Knowhub, Almars, Businessclubs, Sesc, Afrimed, Pharem, Tangram sipas konfirmimit të koordinatorëve pritëse të përfundojnë brenda vitit 2022.


Bazuar në shkresën nr. 862/1 Prot., datë 21.06.2022, të Zv. Rektorit për kërkimin shkencor dhe zhvillimin institucional UV-ja ka aplikuar në disa projekte dhe për vitin 2023 parashikohet të disbursohen rreth 150,000 Eur.

11.1. Të ardhura - hyrjet e fondeve.

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 109 "Institucionet publike të Arsimit të lartë financohen nga:

- Buxheti i Shtetit.
- Pagesat e studentëve për arsim.
- Të ardhurat për shërbimet e kryera.
- Donacione dhe burime të tjera ligjshme financimi.
- Veprimtaritë kërmimor-Shkencore.

Për vitet 2023-2025 bazuar në shkresat e MAS nr. 48 datë 14.01.2022 "Dërgohen fondet e miratuara për grupin e shpenzimeve korente për vitet 2022-2024", shkresën nr. 378 prot., datë 18.03.2022 "Dërgohet plani i investimeve të miratuara për periudhën 2022-2024" si dhe parashikimit të realizimit të të ardhurave të veta bazuar në shkresën nr. 689/1 prot., datë 27.06.2022 të Zv. Rektorit Akademik buxheti total i UV-së është si më poshtë :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Nr	Emërtimi i projektit	PBA për vitet 2023 – 2025		
		2023	2024	2025
1	Grante dhe transfera (Shpenzime Korente)	509,117	509,117	509,117
2	Grante dhe transfera (Shpenzime Kapitale)	148,757	20,000	
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	115,659	117,943	120,034
4	Financim i huaj	15,550	15,899	15,000
TOTALI		789,319	662,319	664,151

1. a. Granti i buxhetit të shtetit për vitet 2023-2025 është i detajuar si më poshtë:


Nr	Emërtimi i projektit	1. Grante për vitin 2023 – 2025		
		2023	2024	2025
1	Grante për shpenzime korente (paga tshp.operative)	481,387	481,387	481,387
2	Grante për investime	122,000	20,000	
3	Granti për Bursa	27,730	27,730	27,730
Totali		631,117	529,117	509,117

b. Të ardhurat e veta:

Burimi kryesor i krijimit të të ardhurave dytësore janë pagesa e tarifës së shkollimit nga studentët. Për vitin 2023-2025 kemi parashikuar realizimin e të ardhurave sipas tabelës së mëposhtme, limit ky i përlogaritur jo në bazë të numrit të kuotave të parashikuara, por në fakt sipas tendencës së numrit të studentëve të rregjistruar në tre vitet e fundit sipas shkresës së Zv. Rektorit Akademik nr. 689/1 prot., datë 27.06.2022.

Numri i studentëve

Fakulteti	Vitiakademik 2018-2019	Vitiakademik 2019-2020	Vitiakademik 2020-2021	Vitiakademik 2021-2022	Vitiakademik 2022-2023
FE	1757	1301	1128	938	949
FSHTN	1111	1016	898	908	989
FSHH	1753	1670	1541	1126	1078
FSH	1162	954	955	954	943
TOTAL	5783	4,941	4,522	3,926	3,959



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

➤ Pasqyrë Nr.1.(P1): Parashikimi i të ardhurave të veta

Të ardhurat e parashikuara për Projekt-Buxhetin 2023-2025 /000 Lekë						
Emertimi të Ardhurave	Fakti 2021	I pritshmi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	
71096 Të ardhura nga Qeratë	89,625		100	100	100	
71101 Të ardhura nga Tarifat e shkollimit	42,179	43,490	39,577	39,619	41,233	
71101 Të ardhura nga Master profesional	28,810	26,700	28,368	28,488	28,488	
71101 Të ardhura nga Master Shkencor	29,761	32,300	38,293	39,415	38,953	
71101 Të ardhura nga Doktoraturë	0		1,000	2,000	3,000	
71101 Të ardhura nga Libreza Diploma etj.	3,366	1,670	1,035	1,035	1,035	
71101 Të ardhura nga Fotokopje, vërtetime ,etj.	2,751	2,356	2,356	2,356	2,356	
71101 Të ardhura nga Taksë regjstrimi në Universitet	8,078	5,786	3,830	3,830	3769.1	
71110 Të ardhura nga Të tjera (Kurse trajnimit)	5,517	3,000	600	600	600	
72070 Të ardhura nga Sponsorizime	1,960	6,034	500	500	500	
Të ardhura të vitit	122,512	121,336	115,659	117,943	120,034	
B.						
Të ardhura të trashguara						
Të ardhura nga te trashguara nga viti i mëparshëm	109,716	117,495				
A+B	Total te ardhura te Institucionit	232,228	238,831			

Në realizimin e të ardhurave negativisht ndikojnë edhe faktorët si më poshtë:

- Numri i rasteve të cilët përfitojnë përjashtim/reduktim nga pagesa e tarifës së shkollimit.
- Mosshlyerja në kohë e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve.
- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi.

Studentë të cilët përfitojnë përjashtim/reduktim nga tarifa e shkollimit.

Duke u bazuar në vendimet e BA-së për vitin akademik 2021-2022 parashikojmë në total një efekt në reduktimin e të ardhurave si më poshtë:

UV	Reduktim 50% I tarifës/ 000 lekë		Perjashtim nga tarifa/000 lekë	
	Nr. Studente	Efekt.Financ	Nr. Studente	Efekt.Financ
FE	33	1,050	74	1,310
FSHH	67	2,115	95	1,370
FSH	27	849	129	2,090
FSHT	26	831	76	1,400
TOTAL	153	4,845	374	6,170
	Shuma 527 Studentë		11,015 Lekë	



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

II. SHPENZIMET

Nisur nga situata konkrete financiare e darranishme si dhe planifikimin e të ardhurave dytësore për vitet 2023-2025 do të paraqesim për miratim buxhetin të mbështetur në nevojat reale të funksionimit të institucionit.

Ky planifikim i buxhetit synon të mbeshtesë zgjidhjen e nevojave institucionale, akademike, shkencore si dhe studentore, në përputhje me Planin Strategjik të Universitetit.

Duke i'u referuar synimeve të mësipërme dhe gjendjes financiare të institucionit, shpërndarja e të ardhurave për përdorim për vitin 2023-2025 do të planifikohet mbi bazën e kritereve si më poshtë :

- o Për financimin e aktiviteteve (ose shpenzimeve) me karakter të drejtpërdrejtë për forcimin dhe thellimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
- o Financimin e aktiviteteve akademike dhe administrative të institucionit mbi baza reale dhe për nevoja të domosdoshme të funksionimit të tij.
- o Mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucionit dhe të sistemit të të dhënave që është implementuar për vite me radhë në Universitet.
- o Investimet në krijimin e infrastrukturës së përshtatshme të mësimdhënies, dhe përmirësimin e ambienteve fizike mbështetur dhe në VKM nr. 413 "Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të Arsimi të Lartë dhe degëve të tyre".
- o Financim për aktivitete shkencore të departamenteve, ku nga produktet e tyre do të kenë përfitim të drejtpërdrejtë studentët dhe më gjorë.
- o Financime për këshillat studentore për aktivitete të ndryshme me karakter social, apo bashkëpunues me studentë të universiteteve të tjera.

Tërësia e financimeve dhe përdorimi i tyre për mbarëvajtjen e aktivitetit të Universitetit përbën PB– e vitit 2023-2025.

Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga realizimi i artikujve të vitit të kaluar, nga realizimi i pritshëm i këtij viti si dhe nga kërkesat e fakulteteve dhe rektoratit për vitin 2023-2025.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Buxheti Total 2023-2025

LLOGARIE EKONOMIKE	EMERTIMI	VLERA TOTALE 2023 /000 lekë	VLERA TOTALE 2024 /000 lekë	VLERA TOTALE 2025 /000 lekë
600+601	PAGA +SIGURIME	506,442	506,442	506,442
602	SHPENZIME OPERATIVE	78,285	79,255	79,805
602(Ksh)	SHPENZIME KERKIMI SHKENCOR	6,131	7,000	9,000
605	TRANSFERTA +ANETARESIM UV	600	600	600
606	BURSA	27,730	27,730	27,730
230+231	INVESTIME	154,102	26,032	5,573
231	TVSH PROJEKTET	408		0
602	FINANCIM I HUAJ	15,558	15,899	15,000
Totali i Shpenzimeve		789,319	662,959	644,151

1. Shpenzimet për paga:


Bazuar në informacionin e Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë parashikon për vitin 2023-2025 fondin e pagave për 354 personel me kohë të plotë akademik dhe joakademik (ndihmës akademik me karakter mësimor/administrativ dhe personel administrativ) nga të cilët 67 % personel akademik dhe 33% personel ndihmësakademik, si dhe 125 staf të ftuar dhe me kohë të pjeshme.

Shpenzimet për paga janë parashikuar në vlerën 448,749 mijë lekë dhe për sigurime në vlerën 57,969 mijë lekë.

Shpenzime për fond page	Nr. Staf/ore	Fond Page /000 Lekë
Staf akademik me kohë të plotë	240	344,866
Staf ndihmës/akademik me karakter administrativ mësimor dhe personel administrativ	114	104,866
Orë suplementare	50,227	44,501
Staf Akademik I ftuar (2500 orë)	25	6,325
Staf Akademik me kohë të pjeshme(8000 orë)	80	6,160
Totali		506,718

Planifikimi për zërin shpenzime paga është bërë duke patur parasysh faktet si më poshtë :

- Strukturën organike sipas Vendimin e Senatit Akademik nr. 12 datë 27.02.2019 dhe vendimit të Bordit të Administrimit nr. 17 datë 03.04.2019.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

- Numri dhe emri i pedagogëve sipas të titujve që mbajnë aktualisht, si dhe kualifikimet e mundshme të tyre me detyrime pasuniversitare për kalimin e shkallëve të kualifikimit, funksione drejtuese në administratë, etj.
- Orët suplementare të parashikuara për stafin me kohë të plotë.
- Numri dhe ngarkesa e stafit të ftuar dhe me kohë të pjesshme.

Shpenzimet Operative

Në planifikimin e shpenzimeve operative janë përcaktuar limitet të përdorimit të fondeve në nivel të domosdoshëm, të cilat do të mundësojnë shpenzimet në ritje në disa zëra si energji, ujë, telefon, në shërbimet që dalin të detyruara si p.sh. shpenzimet për rojet private, shpenzimet për internetin, shpenzime për mirëmbajtje, shpenzime qira etj.

Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga realizimi i artikujve të vitit të kaluar, nga realizimi i pritshëm i këtij viti si dhe nga kërkesat për disa lloj shpenzimesh.

Në zërat e shpenzimeve operative janë përfshirë edhe shpenzimet që mbështesin zhvillimin e konferencave të ndryshme (pritje përejellje, tjetje në hotel e të huajve, mbajtjen e konferencave, organizim workshop, pagesë për pjesmarrje në konferenca, pagesë për botim artikuj shkencor etj.). Ky zë është parashikuar nga eksperiencia e mëparshme si dhe kërkesat e njëjësive bazë.

Artikulli	Përshkrimi	000/Leke				
		Fakti 2021 2021	I pritshmi 2022	Parashikimi 1 2023	Parashikimi 1 2024	Parashikimi 1 2025
<i>I</i>				<i>7</i>	<i>8</i>	<i>6</i>
	<<Emergjimi i Programit>>					
602	Materialë zyre dhe të përgjithshme	4,936	5,450	5,600	5,400	5,200
602.1	Materialë dhe shërbime speciale	3,039	11,872	6,500	7,000	7,500
602.2	Shërbime nga të tjerë	17,392	18,549	19,749	19,619	19,769
602.3	Shpenzime transporti	612	1,350	1,650	1,450	1,450
602.4	Shpenzime udhëtimi	344	2,500	5,000	5,000	4,500
602.5	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	1,807	2,420	2,000	2,000	1,600
602.6	Shpenzime për qeramarrje	11,555	11,287	11,287	11,287	11,287
602.7	Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale	1,832	4,000	5,000	5,000	5,000
602.9	Shpenzime të tjera operative	16,732	21,117	21,500	22,500	23,500
	Totali	58,950	78,545	78,286	79,256	79,806



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

Shpenzime për kërkimin shkencor.

Bazuar në strategjinë e kërkimit shkencor për Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, në mbështetje të misionit dhe arritjen e synimeve të kërkimit shkencor në UV-së, vlera e llogaritur për këtë shpenzim është 6,131 mijë lekë.

Në këtë zë të shpenzimeve janë llogaritur shpenzimet në mbështetje të projekteve kërkimore shkencore të fakulteteve, si dhe bashkëfinansim për projektet me financim të huaj.

Nr	Emërtimi	000/lekë
		Nga të ardhurat
	6029099 Kërkimi shkencor (20/70)	
1	Fondi për kërkim shkencor për vitin 2023	2,000
2	Bashkëfinansim për projektet me financim të huaj	2,083
3	Projekti Folata	1,172
4	Projekti ALB- 18/0003 Promoting Education & Identifying Gap	876
	Total	6,131

Fondi i akorduar nga të ardhurat e UV-së në mbështetje të kërkimit shkencor në Universitet është parashikuar 500 mijë lekë për secilin fakultet për të cilin do të zbatohet vendimi i Senatit Akademik nr.16 datë 06.05.2021 për "Miratimin e procedurës së aplikimit, miratimit, implementimit dhe pagesës së mini-projekteve të financuara nga buxheti i UV-së".

Projektet pas shtypjes fitues do t'i përcillen Administratorit së bashku me buxhetin e detajuar.

- Në këtë llogari të shpenzimeve përfshihen dhe fondet e ardhura përmes llogarisë në thesarit për projektin Folata për të cilin priten të disbursohen 9,600 Eur dhe projekti ALB- 18/0003 Promoting Education & Identifying Gaps/Needs in Albanian Maritime në vlerën 876 lekë.

- Bashkëfinansimi për projektet me financim të huaj bazuar në buxhetet e projekteve dhe në kërkesat e koordinatorëve të projekteve është në vlerën 10.920 Eur të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Gjithashtu është parashikuar dhe një fond prej 2,500 mijë lekë për projektet e reja.

Bursat (Llogaria 606).

Shpenzimet për bursa mbulohen 100% nga buxheti i shtetit. Granti i akorduar për Bursa për UV-në për përballimin e efekteve financiare që kanë ardhur nga zbatimi i akteve ligjore për kategoritë e studentëve që përfitojnë bursë financiare është 27,730 mijë lekë.

Artikulli 606 kapitulli 3 përfshin të gjitha ato shpenzime për të cilat institucioni nuk përfiton mallra ose shërbime. Shpërndarja e buxhetit në këtë artikull pasqyron kërkesat e institucionit tonë për bursat e studentëve të cilat planifikohen në zbatim të vendimit nr. 903, datë 21.12.2016 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

nevojë" përdryshuar me Vendimin nr. 784, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave, si dhe me Vendimin nr. 39 datë 23.1.2019 të KM, bazuar dhe në numrin faktik të bursistëve sipas vendimeve të Bordit të Administrimit për vitin akademik 2020-2021 dhe realizimit të vitit 2021.

UV	Studente ekselente		Studente ne nevojë	
	Nr. Studente	Efekt. Financiar/000 Leke	Nr. Studente	Efekt. Financiar/000 Leke
FE	23	1,955	41	3,485
FSHH	27	2,295	50	4,260
FSH	33	2,805	72	6,120
FSHT	32	2,720	48	4,090
TOTAL	115	9,775	211	17,955

Investimet (logaria 231)

Në projekt- buxhetin e vitit 2023-2025 prioritet i është kushtuar investimeve për krijimin e infrastrukturës së më të përshtatshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, aktiviteteve akademike, mbështetjes studentore, promovimit të institucionit tonë në rajon e më gjerë, duke krijuar kushte sa më të favorshme për këtë qëllim.

Nisur nga niveli i të ardhurave të parashikuar, duke marrë në konsideratë të mbulohen gjithë shpenzimet e pagave, kërkimit shkencor dhe shpenzimet për mbarëvajtje normale të punës, kondicionuar nga këto kushte për investime për vitin 2023 janë parashikuar 154,102 mijë lekë investime nga të cilat 143,982 mijë lekë janë nga buxheti shtetit dhe 5,120 mijë lekë janë nga të ardhurat e institucionit.

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE REKREATIVIT

Tabela nr. 1.2 Plani i detajuar i investimeve për vitin 2020-2023 (Kujtoju për shprehje financiare të investimeve të ardhura të vitit dhe bux

7	9	10	11	12	13	14	15	16
Logarit e ekonomike	Kodi i projektit	Emertimi i projektit të investimit	Vlera e plotë e projektit	Buxheti 2022 Plani	Realizimi	Investimet për buxhetin 2023	Parashikimi për vitin 2024	Parashikimi për vitin 2025
2-12103	180512	NDERTIMI I OBJEKTIT TË RI TË FSH-SE	200,000	122,000	0	118,982	200,000	
2-12103	91105AA	NDERTIMI I OBJEKTIT TË RI TË FSH-SE	121,000	121,700	0	0	0	
2-02100	91105AA	MIRQYRIA NDERTIMI I OBJEKTIT TË RI TË FSH-SE	3,971	3,971	0			
2-02100	91105AA	KOLAUDIMI NDERTIMI I OBJEKTIT TË RI TË FSH-SE	510				510	
2-18100	91105AA	BLERJE INVENTAR EKONOMIK	5,123		0	600		1,523
2-18100	91105AA	BLERJE FOTOKOPJE PUNËTRIA	2,700			2,700		
2-18100	91105AA	NDERTIMI RAMPË	900			900		
2-18100	91105AA	FONI SALLA BILINDIA-BIBLIOTEKA	920			920		
2-18600	91105AA	BLERJE INVENTAR ELETKRONIK	2,492				2,492	
2-14140	91105AA	NGERTIJE LABORATORI	5,000	5,000		0	3,000	0
2-12112	91105AA	BLERJE LITERA	1,600	1,600	0			1,600
Totali			438,984	257,277	0	154,102	25,032	5,573

Puna jonë edhe në vazhdim. do të konstitojë në mbështetjen dhe realizimin e misionit të UV-së, në krijën e cilësisë së mësimdhënies duke krijuar kushte sa më të favorshme, si dhe krijën e impaktit të Institucionit në rajon dhe më gjerë duke u mbështetur në Ligjin e Buxhetit të Shtetit, në Ligjin e Arsimit të Lartë, kërkesat e fakulteteve dhe strukturave përkatëse si edhe në strategjinë e Universitetit duke vendosur prioritete bazuar në kërkesat për realizimin e aktivitetit të UV në gjithë zërat e parashikuar të shërbimeve, shpenzimeve operative, investimeve etj.

...TETI@ISMAIL

ADMINISTRATOR

Saimir XHELAJ

